

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE

Nr/Br. 232 / 22
Datë/Datum. 08.07.2022

PRISHTINË - PRIŠTINA


1



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	Data e autorizimit të ekspertit	Data e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Gjemajli Bellanica; 	30.05.2022	08.07.2022	232/22

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 27.06.2022 OE NNP “CTA” Sh.p.k Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr. **232/22** kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit ku është rekomanduar për kontratë OE “ENGROUP” Sh.p.k, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i çerdhes në Rufc të Ri – Ri-tenderim”, me nr. të prokurimit: **613-22-4220-5-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KK – Lipjan**.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar, procedurë të hapur, Punë, vlera e parashikuar e kontratës: 260.000.00 €

Data e njoftimit për kontratë.....11.05.2022.
Hapja e ofertave.....01.06.2022.
Data e njoftimit të vendimit të AK-së.....22.06.2022.
Data e kërkesës për rishqyrtim.....22.06.2022.
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesës për rishqyrtim.....24.06.2022.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE TË: OE NNP "CTA" Sh.p.k
Prishtinë

Dispozitat e shkelura

Neni 56 - Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
Neni 56.3 -
Neni 60 – Kriteret për Dhënien e Kontratës
Neni 41 – i RROUPP

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet

Letra standarte per tenderuesin e eliminuar me date 22.06.2022 po ne te njeten date ne eprokurimi eshte bere edhe Njoftimi mbi Vendimin e AK –Titulli i kontrates se dhene nga

AK kompanise 'ENGRUP shpk ne vlere prej 213,309.04EURO

AK na ka eliminuar per kete arsye

ARSYETIM

[Ju jeni diskualifikuar.] [Tenderi juaj është refuzuar] për këto arsye :

[Deklaroni arsyet e hollësishme mbi refuzimin në përruthtie me rrethanat]

Komisioni gjate vlersimit ka verejtur se OE "C.T.A "N.N.P ne Komunen e Lipjanit ka ofertuar ne tri projekte ,prej tyre per dy eshte fitues; "Nderitmi I Qerdhes ne Shalë"afati per kryerje eshte 300.dite dhe "Ndertimi I shkolles ne Ribar te Madh"afati per kryerje eshte 250.dite ,ndersa edhe ne projektin "Nderimi I Qerdhes ne Rufe te Ri eshte me i liri

Komisioni ka verejtur se OE ne fjale ka te njejtin staf dhe te njejtta paisje ne tri projektet .

Pasi qe secili projekt e ka afatin per kryerjen e punimeve ne mendojme se ky OE nuk ka mundesi potenciale te i realizon te tri projektet ne te njeten kohe,staf dhe paisje

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit .

Me respekt,

Bekim Shabani

[Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit]

[Fshatimi]
(Nënshkrimi)

Pretendimi nr1:

AK ka shkelur Neni 1 te LPP-se: pasi nuk ka shfrytëzuar fondet publike ne menyre efikase pasi qe shperblen me kontrate OE ENGRUP shpk ne vlere prej 213,309.04EURO

Qmimi i OE te shpallur fitues eshte 213,309.04EURO euro kurse oferta jone ishte me qmimim me te ulet ashtu siq eshte kerkuar ne DT dhe njoftimin per kontrate .

Qmimi ofertues i kompanise NNP"CTA"SHPK eshte 207,404.62euro kurse i OE i dmth buxheti i shtetit eshte demtuar per 5,904.42euro

Pretendimi nr2:

- AK ka shkelur nenin 56 të LPP-së – i cili kërkon që gjatë vlerësimit të tenderëve:

56.1.1 - së pari të kryhet vlerësimi i tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, dhe 56.1.2 - së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kriterëve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji.

56.3. Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit

AK na ka diskualifikuar lidhur me stafin profesional si dhe makinerin qe kemi ne 3 projekte nje kerkes e till nuk ka qen e specifikume ne dt dhe njoftimin per kontrate

Ne vitin 2022 neve kemi te neshkruar vetem nje kontrat edhe ate ndertimi i shkolles ne fshatin ribar i madh ku ne vitin buxhetor 2022 jane te parapara vetem 100,000.0euro investim

Ndertimi i qedhes ne shale lenda eshte ne oshp me PSH.NR103/22 ende ska vendim as nuk ka te formuar bord te oshp qe dmth kjo lende ende nuk dihet si do te perfundon pasi qe ESH ka kerkuar qe lenda te kthehet ne rishqyrtim.

KERKESAT E KERKUARA NGA AK NE NJOFTIMIN PER KONTRATE

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për projekte të ngjashme në vlerë prej 380,000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrate	Dëshmia 1. Nje liste e kontratave të nënshkruar dhe vëlosur nga OE ku do të bëhet përshkrimi me këto informata titullin e kontratës, klientin, datën e fillimit të kontratës, datën e përfundimit të kontratës, vlerën e kontratës, Referencat apo pranimin teknik kopje për kontratat e prezentuara për projekte të ngjashme, Nëse kontrata me reference është me kompani private të deshmohet me transaksion bankar (deshmi që është kry pagesa). Referencat apo pranimet teknike duhet të jenë në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrate.
Kërkesa 2. Stafit Profesional a) Min. Nje Inxhinier i diplomuar i arkitektures, sistemi 5 vjeçar ose master i njejtë të caktohet edhe si menaxher për këtë projekt. b) Min. Një Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikës sistemi 5 vjeçar ose master. c)	Dëshmia 2. Lista e stafit duhet të dorëzohet e nënshkruar dhe e vëlosur nga OE. a).Vendimi me shkrim mbi caktimin e menaxherit për këtë projekt i nënshkruar dhe vëlosur nga OE b).Për stafin profesional të deshmohen me CV,

B05 Njoftim për Kontrat

4 / 7

Min. Nje gjeodet i diplomuar bachelor apo master të jetë i paisur edhe me licence me afat për matje gjeodezike. d) Min. Nje Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë - drejtimi konstruktiv, sistemi 5 vjeçar ose master. e) Min 10 puntor.	diploma, Kontratat e punës ose parakontrata për këtë projekt, licenca për gjeodet me validitet. Për puntoret kërkohen kontratat e punës ose parakontrata për këtë projekt.
Kërkesa 3. Lista e pajisjeve teknike a. Eskavator min (1 copë) b. Kamion min (2 copë) Cilinder min (1 copë)	Dëshmia 3. Lista e pajisjeve të nënshkruar dhe vëlosur nga OE, për automjetet që nuk regjistrohen Deklaratat unike doganore apo faturat e blerjes. Për automjetet që regjistrohen Librezat e qarkullimit me validitet. Në rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin e mjeteve, OE duhet të dorëzojë edhe marrëveshjen për shfrytëzim dhe dëshmit tjera përkatëse.

KERKESAT E KERKUARA NGA AK NE DT

		<p>Kerkesa 2. Stafin Profesional a) Min. Nje Inxhinier i diplomuar i arkitektures, sistemi 5 vjeqar ose master i njejt i caktohet edhe si menagjer per kete projekt. b) Min. Nje Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikes sistemi 5 vjeqar ose master. c) Min. Nje gjeodet i diplomuar bachelor apo master te jete i paisur edhe me licence me afat per matje gjeodezike. d) Min. Nje Inxhinier i diplomuar i ndertimtarise - drejtimi konstruktiv, sistemi 5 vjeqar ose master. e) Min 10 puntor.</p>	<p>Deshmia 2. Lista e stafit duhet te dorzohet e nenshkruar dhe e vulosur nga OE. a).Vendimi me shkrim mbi caktimin e menaxherit per kete projekt i nenshkruar dhe vulosur nga OE b).Per stafin profesional te deshmohen me CV, diploma, Kontratat e punes ose parakontrata per kete projekt, licenca per gjeodet me validitet. Per puntoret kerkohen kontratat e punes ose parakontrata per kete projekt.</p>
		<p>Kerkesa 3. Lista e pajisjeve teknike a. Eskavator min (1 copë) b. Kamion min (2 copë) Vibrator min (1 copë)</p>	<p>Deshmia 3. Lista e pajisjeve e nenshkruar dhe vulosur nga OE, per automjetet qe nuk regjistrohen Deklaratat unike doganore apo faturat e blerjes. Për automjetet qe regjistrohen Librezat e qarkullimit me validitet. Ne rastet kur OE ka marveshje per shfrytezimin e mjeteve, OE duhet te dorezoj edhe marveshjen per shfrytezim dhe deshmite tjera perkatese.</p>
	11.1	a. një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht	

Ketu shihet qart qe AK na ka eliminuar pa asnje arsye sepse nje kerkes e til nuk ka qen e specifikuar fare ne dosjen e tenderit dhe njoftimin per kontrate.

Pretendimi nr3:

- AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së sepse si pasojë e mos vlerësimit real të ofertave dhe trajtimit të dëshmimeve simbas kërkesave ne dosjes së tenderit na ka eliminuar duke na konsideruar si te papergjegjshem . Kjo përbën shkelje të kriterit që tenderi do ti jepet tenderuesit të përgjegjshëm që posedon çmimin më të ulët.

Oferta yne eshte me qmim 207,404.62euro ku shihet se eshte qmim me te ulet se Oferta OE te shpallur fitues qe eshte 213,309.04euro

Pas gjithë këtyre sqarimeve, dhe fakteve të ofruara shpresojmë dhe besojmë se OSHP do ta shqyrtoj me kujdes Ankesën tonë dhe njuhërit do ta aprovoj si të bazuar.

Pretendimi nr4:

- AK ka shkelur nenin 41. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahassimi i Tenderëve te RROUP-se

41.11 Tenderuesi nuk do te diskualifikohet ose nuk do te perjashtohet nga procedura e prokurimit ne baze te ndonje kerkese apo kriteri **qe nuk eshte i specifikuar** ne njoftimin e

kontrates /dhe dosjen e tenderit.

AK na ka eliminuar pa asnje arsye sepse nje kerkese e til nuk ka qen e specifikuar fare ne dosjen e tenderit dhe njoftimin per kontrate ;

Aryeja e eliminimit eshte sepse stafin profesional si dhe makinerin qe kemi ne 3 projekte jane te njejt.

Po ashtu kërkojmë nga OSHP që pas shqyrtimit të Ankesës tonë dhe verifikimit të fakteve, të marrë:

VENDIM

APROVOHET si e bazuar Ankesa e OE “N.N.P. CTA”shpk lidhur me tenderin Ndërtimi i qerdhes në Rufc të Ri - Ritenderim me nrp: 613-22-4220-5-2-1

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK- Ndërtimi i qerdhes në Rufc të Ri dhe lënda të kthehet në RI-VLERËSIM.

AK-së të i kërkohet që Ri-vlerësimin ta bëjë bazuar plotësisht në kërkesat e dosjes së tenderit që realisht më pas do duhej që fitues te shpallej OE “NNP”CTA”shpk

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale

Kërkesa 1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo Regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit

Kërkesa 2.Certifikata e TVSH-se

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiareN/A**Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale**

Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për projekte të ngjashme në vlerë prej 380,000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrate

Kërkesa 2. Staf i Profesional a) Min. Një Inxhinier i diplomuar i arkitekturës, sistemi 5 vjeçar ose master i njëjti të caktohet edhe si menaxher për këtë projekt. b) Min. Një Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikës sistemi 5 vjeçar ose master. c) Min. Një gjeodet i diplomuar bachelor apo master të jetë i pajisur edhe me licence me afat për matje gjeodezike. d) Min. Një Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë - drejtimi konstruktiv, sistemi 5 vjeçar ose master. e) Min 10 punëtor.

Kërkesa 3. Lista e pajisjeve teknike a. Eskavator min (1 copë) b. Kamion min (2 copë) Vibrator min (1 copë)

Dëshmitë e kërkuara dokumentare të përshtatshmërisë profesionale

Dëshmia 1. Certifikata e regjistrimit të biznesit (kopje)

2. Certifikata e TVSH-kopje.

Dëshmitë e kërkuara dokumentare mbi gjendjen ekonomike dhe financiareN/A**Dëshmitë e kërkuara mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale**

Dëshmia 1. Një listë e kontratave të nënshkruar dhe vëlosur nga OE ku do të bëhet përshkrimi me këto informata titullin e kontratës, klientin, datën e fillimit të kontratës, datën e përfundimit të kontratës, vlerën e kontratës, Referencat apo pranimin teknik kopje për kontratat e prezantuara për projekte të ngjashme, Nëse kontrata me reference është me kompani private të dëshmohet me transaksion bankar (dëshmi që është kryer pagesa). Referencat apo pranimet teknike duhet të jenë në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrate.

Dëshmia 2. Lista e stafit duhet të dorëzohet e nënshkruar dhe e vulosur nga OE. a).Vendimi me shkrim mbi caktimin e menaxherit për këtë projekt i nënshkruar dhe vulosur nga OE b). Për stafin profesional të dëshmojnë me CV, diploma, Kontratat e punës ose para kontrata për këtë projekt, licenca për gjeodet me validitet. Për punëtorët kërkohen kontratat e punës ose para kontrata për këtë projekt.

Dëshmia 3. Lista e pajisjeve të nënshkruar dhe vulosur nga OE, për automjetet që nuk regjistrohen Deklaratat unike doganore apo faturat e blerjes. Për automjetet që regjistrohen Librezat e qarkullimit me validitet. Në rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin e mjeteve, OE duhet të dorëzojë edhe marrëveshjen për shfrytëzim dhe dëshmitë tjera përkatëse.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Komuna Lipjan shpërblen me kontratë ENGRUP SH.P.K.,,ne vlerë totale të ofertës 213 309,04.€

VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE NNP “CTA”Sh.p.k Prishtinë

Në këtë ankesë OE ankues pretendimet ankimore i ka ngritur lidhur me arsyen e eliminimit të tij nga ana e AK-së.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 1

OE ankues pretendon se AK ka shkelur Nenin 1 të LPP-së pasi nuk ka shfrytëzuar fondet publike në mënyrë

efikase pasi që shpërblen me kontratë OE "ENGROUP" sh.p.k në vlerë 213 309.40 EURO, kurse oferta jonë ishte me çmim më të ulët ashtu siç është kërkuar në DT dhe njoftimin për kontratë. Ndërsa buxheti i shtetit është dëmtuar në vlerë 5.904.42 Euro.

Lidhur me këtë pretendim ankimor, eksperti shqyrtues sqaron se oferta e operatorit ekonomik ankues është: 207 404.62 Euro, ndërsa oferta e OE të rekomanduar për kontratë është 213 309.04 Euro, me gjithsej dallim në shumë prej 5 904.42 Euro, më i shtrenjtë se sa OE ankues. Andaj duke pas parasysh kriterin e dhënies së kontratës si dhe Nenin 1 të LPP-së, AK-ja do të duhej të vlerësoj tenderët konform kërkesës së dosjes së tenderit.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 2

OE ankues thekson se AK-ja ka shkelur nenin 56 të LPP-së, e cila na ka diskualifikuar lidhur me stafin profesional si dhe makinerinë që kemi në 3 projekte një kërkesë e tillë nuk ka qenë e specifikuar në DT dhe njoftimin për kontratë.

AK-ja na ka eliminuar pa asnjë arsye për faktin se arsyeja e eliminimit nga ana e AK-së nuk ka qenë e specifikuar fare në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Në letrën standarde për tenderues OE ankues është eliminuar me arsyetimin se:

Komisioni gjatë vlersimit ka verejtur se OE "C.T.A "N.N.P ne Komunen e Lipjanit ka ofertuar ne tri projekte ,prej tyre per dy eshte fitues; "Nderitmi I Qerdhes ne Shalë"afati per kryerje eshte 300.dite dhe "Ndertimi I shkolles ne Ribar te Madh"afati per kryerje eshte 250.dite ,ndersa edhe ne projektin "Nderimi I Qerdhes ne Rufc te Ri eshte me I lirë

Komisioni ka verejtur se OE ne fjale ka te njejtin staf dhe te njejta paisje ne tri projektet .

Pasi qe secili projekt e ka afatin per kryerjen e punimeve ne mendojme se ky OE nuk ka mundesi potenciale te I realizon te tri projektet ne te njejten kohe,staf dhe paisje

Eksperti shqyrtues, sqaron se arsyeja e eliminimit të OE ankues është në kundërshtim me Nenin 56.3 të LPP-së, për faktin se një kërkesë e tillë nuk ka qenë e specifikuar në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë. Andaj pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 3

OE ankues thekson se AK-ja ka shkelur Nenin 60 të LPP-së sepse si pasoj e mosvlerësimit real të ofertave dhe trajtimit të dëshmive sipas kërkesave të dosjes së tenderit na ka eliminuar duke na konsideruar si të pa përgjegjshëm. Kjo përbën shkelje të kriterit që tenderi do ti jepet tenderuesit të përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Eksperti shqyrtues konstaton që në Nenin 30.1 të Dosjes së tenderit si kriter i dhënies së Kontratës është përcaktuar: “Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më të ulët**”, andaj AK-ja është dashur të veproj konfrom kërkesave të përcaktuar në dosje të tenderit dhe të veproj në harmoni me nenin 60 të LPP-së. Pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 4

OE ankues thotë se AK-ja ka shkelur nenin 41.11 të RRUOPP, pasi na ka eliminuar pa asnjë arsye, sepse një kërkesë e tillë nuk ka qenë e specifikuar në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë. Arsyeja është sepse stafin profesional si dhe makinerinë që kemi në 3 projekte janë të njëjtë.

Eksperti shqyrtues thekson se edhe në Nenin 41.11 të RRUOPP-së është përcaktuar se: citat “*Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit*”, mbyll citatin. Andaj vlerësoj se arsyeja e eliminimit të OE ankues është në kundërshtim me nenin 41.11 për faktin se një arsyetim i tillë nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Andaj pretendimi i OE ankues është i bazuar.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE NNP “CTA”Sh.p.k Prishtinë të aprovohet si e bazuar, dhe rekomandon që lënda të kthehet në Rivlerësim.

Raporti i ekspertizës t’i dorëzohet:

Autoritetit Kontraktues	- KK - Lipjan
Panelit Shqyrtues	- OSHP
OE ankues	-OE NNP “CTA”Sh.p.k Prishtinë